

Gjykata Themelore në Prishtinë
PKR. Nr. 383/09

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

9 shtator 2014

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Piotr Bojarczuk si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik dhe gjyqtarja vendore Nora Bllaca-Dula si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga asistenti ligjor i EULEX-it Musa Bajraktari, në çështjen penale PKR. 383/2009 kundër të pandehurve në vijim të ngarkuar me aktakuzën e Prokurorisë së Shtetit, PP. nr. 465-6/09, të datës 13 gusht 2009, dhe konfirmuar me aktvendim të gjyqtarit për konfirmim, KA. Nr. 348/09, të datës 05.10.2009 në rastin penal kundër:

1. **A.C.**, emri i babës xxxx, i nënës xxxx e gjinisë xxxx, i lindur më xxxx në fshatin xxxx e xxxxx, i akuzuar për veprat penale në vijim:

1.1. ‘se më 22.05.2009, rreth orës 13:40, në fshatin Zabel i Ulët, Komuna e Drenasit/Gllogocit, në afërsi të xhamisë së fshatit, për shkak të marrëdhënieve të acaruar dhe konflikteve të vazhdueshme mes të pandehurit A.C., me Q.A., e bija e të ndjerit R.A., me të cilën ishte i martuar i pandehuri A.C., dhe për shkak të dhunës së vazhdueshme që është përdorur ndaj saj nga bashkëshorti, ajo kishte lënë shtëpinë e saj shumë herë dhe kishte shkuar në shtëpinë e babës së saj, me automjetin e tipit “Mercedes”, ngjyrë të përhimët, pronë e të pandehurit të dytë, i cili automjet është përdorur nga i pandehuri R.O.. A.C. doli nga shtëpia e tij në fshatin Korroticë, ai shkoi në fshatin Zabel i Ulët në afërsi të xhamisë, ku ai e parkoi automjetin dhe ka pritur rreth 30 minuta për babën (tani i ndjeri) e ish-gruas së të pandehurit A.C., i cili në atë kohë ishte brenda në xhami duke u lutur, automjeti i të cilit ishte vërejtur se ishte i parkuar më parë nga i pandehuri A.C., prandaj ai e dinte se ai ishte aty, kështu që kur i ndjeri doli nga xhamia dhe ia afrova automjetit të tij, për shkak të hakmarrjes së paskrupullt, duke menduar se ai ishte arsyeja pse bashkëshortja e tij nuk po kthehej në shtëpi, i pandehuri A.C.me qëllim që ta privoj nga jeta, iu afrova të ndjerit dhe në një distancë prej 3-4 metra largësi, ka qëlluar katër herë me armë automatike ndaj tij, duke e goditur atë me katër plumba në pjesët vitale të trupit, duke i shkaktuar atij plagë vdekjeprurëse, për shkak të cilave personi në fjalë ka vdekur menjëherë. Pas kryerjes së veprës penale me të njëjtin automjet ai u kthye në fshatin Korroticë në shtëpinë e tij.

e cila veprë në aktakuzën e ngritur është cilësuar si Vrasje e Rëndë sipas nenit 147, pika 9 e Kodit Penal të Kosovës (më poshtë “KPK”);

1.2. ‘se me datën, kohen dhe vendin e përshkruar më lartë në piken 1, pa pasur leje të vlefshme të lëshuar nga organi përkatës (Ministria e Punëve të Brendshme) për mbajtje të autorizuar të armës së tillë, ai ka qenë në posedim të armës automatike “AK-47”, (kalibri 7.62x39mm

me numër serik 09809-84) të cilën e kishte marrë nga shtëpia e tij dhe ka kryer veprën penale të përshkruar nën piken 1’,

e cila vepër në aktakuzën e ngritur është cilësuar si Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armeve sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, në lidhje me veprën penale të përshkruar më lartë nën piken 1;

2. **R.O.** emri i babës xxxx, emri dhe mbiemri i gjinisë së nënës xxxx, i lindur më xxxxxx në xxxxxx, i akuzuar për veprën penale në vijim:

2.1. ‘se me datën, kohën dhe vendin e përshkruar më lartë në piken I.1, ai kishte marrë pjesë në ofrimin e ndihmës, duke pritur jashtë automjetit për rreth 30 minuta, ku i pandehuri i parë i kishte shkaktuar vdekjen të ndjerit, R. A.’,

e cila vepër në aktakuzën e ngritur është cilësuar si Ofrim i ndihmës në kryerjen e Vrasjes së Rëndë sipas nenit 147 paragrafit 1, pikës 9, në lidhje me nenin 25 të KPK-së;

Pas mbajtjes të seancave publike të shqyrtimit kryesor në datat 15,18, nëntor dhe 11 dhjetor 2013 dhe 17, 21, 23, janar, 13 shkurt, 07 mars 2014, 11 prill 2014, 02 korrik 2014 dhe 5 shtator 2014.

në praninë e:

- të pandehurit A.C. dhe avokatit të tij mbrojtës, D. R.;
- të pandehurit R.O. dhe avokatit të tij mbrojtës I. D., më 07 mars 2014 i pandehuri R.O. Osmani ishte paraqitur nga B. A., dhe
- pala e dëmtuar Z. A. dhe përfaqësuesi i saj, R. G.;

pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 05 shtator 2014, në përputhje me nenin 359 paragrafin të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (më poshtë KPP),

më 9 shtator 2014, në lidhje me nenin 359 të KPP-së, shpall publikisht si në vijim:

AKTGJYKIM

I. A.C. shpallet FAJTOR sepse:

më 22.05.2009, rreth orës 13:40, në fshatin Zabel i Ulët, komuna e Glllogocit/Drenasit, afër xhamisë së fshatit:

ka qenë në posedim të armës automatike “AK-47 kalibër 7.62x39mm me numër serik 09809-84 pa ndonjë autorizim të armës apo leje e cila ishte arme e kategorisë A2 e përcaktuar me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1.2 të Ligjit mbi Armët të datës 17 shtator 2009 (Ligji Nr. 03/L-143), dhe:

ai qëllimisht kishte përdorur AK-47 në atë mënyrë duke ia drejtuar armen dhe shkrepur katër herë në drejtim të R.A.t, i cili ishte duke qëndruar para oborrit të xhamisë, përderisa ishte duke e hapur derën e veturës së tij ku përafërsisht 20 persona të tjerë ishin duke dalë nga xhamia pas mbarimit të lutjeve të Xhumasë;

dhe me këtë veprim A.C. në mënyrë të qëllimshme e ka privuar nga jeta të ndjerin R.A. duke e qëlluar me katër plumba në pjesët vitale të trupit, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse për shkak të cilave personi ka vdekur menjëherë;

dhe duke kryer një veprim të tillë, A.C. ka kryer në bashkëveprim veprat penale në vijim:

- I.1. Posedim i paautorizuar i armeve sipas nenit 374 paragrafit 1 të KPK-së;
 - I.2. Vrasje e Rëndë sipas nenit 147, pikës (9) të KPK-së;
- II. **A.C.** në këtë mënyrë DËNOHET:
- në përputhje me nenin 3 paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i hyrë në fuqi më 1 janar 2013 (më poshtë “KPRK”) në lidhje me nenin 374 paragrafin 1 të KPRK-së, për veprën penale të posedimit të paautorizuar të armës sipas nenit 374 paragrafit 1 të KPRK-së të përshkruar nën I.1, me dy (2) vite burgim;
 - II.1. në përputhje me nenin 3 paragrafit 2 të KPRK-së, në lidhje me nenin 147, pikës 9 të KPK-së, për veprën penale të vrasjes së rëndë me burgim afatgjatë për një periudhë prej 25 (njëzet e pesë) vite;
 - II.2. në përputhje me nenin 3 paragrafit 2 të KPRK-së, në lidhje me nenin 71 paragrafët 1 dhe 2.1 të KPRK-së, në këtë mënyrë për të dy veprat penale më lartë A.C. dënohet me një dënim të bashkuar prej 25 (njëzet e pesë) vite burgim.
- III. 364 paragrafin 1 nën-paragrafin 1.3 të KPP-së, **R.O.** SHPALLËT I PAFAJSHËM sepse nuk është vërtetuar në standardin e kërkuar apo përtej dyshimit të arsyeshëm se më 22.05.2009, rreth orës 13:40, në fshatin Zabel i Ulët, Komuna e Drenasit, afër xhamisë së fshatit, ai ka marrë pjesë në ofrimin e ndihmës, duke pritur brenda në veturë rreth 30 minuta, përderisa i pandehuri i parë i ka shkaktuar vdekjen të ndjerit, R. A.
- IV. Në përputhje me nenin 374 paragrafit (3) të KPRK-së, arma automatike “AK-47” kalibër 7.62x39mm me numër serik 09809-84 do të konfiskohet menjëherë dhe të shkatërrohet.
- V. Pala e dëmtuar mund të ngrit padi për kompensim përmes gjykatës civile.
- VI. Në përputhje me nenin 365 paragrafin 1, pikës 1.5 të KPP-së, periudha e heqjes së lirisë ndaj A.C.t nga data 22 maj 2009 deri 09 shtator 2014 do të përfshihet në dënimin e bashkuar afatgjatë të caktuar ndaj tij.

- VII. Në përputhje me nenin 453 paragrafin 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale kompensohen pjesërisht nga i pandehuri A.C. në shumën paushtë prej 100 euro dhe pjesa tjetër e shpenzimeve duhet të paguhet nga mjetet buxhetore.

Gjykata Themelore në Prishtinë

PP. Nr. 383/2009

Datë 9 shtator 2014

Procesmbajtëse

Kryetari i Trupit Gjykes

Svetelina Zhekova

Piotr Bojarczuk

Anëtare e trupit gjykues

Anëtare e trupit gjykues

Mariola Pasnik

Nora Bllaca-Dula

Duke u mbështetur në nenin 287 paragrafin 2 të KPP-së, palët kanë detyrim të paralajmërojnë ankesë brenda 15 ditëve.

Kundër aktgjyqimit mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së këtij aktgjyqimi (neni 380 paragrafi (1) KPP-së).